



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Prof. 4603
Dt. 17.06.20

URDHËR

Nr. 183, Datë 17.06.2020

PËR

**PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË OPERIMIT TË MJETEVE LUNDRUESE PËR
QËLLIME TURISTIKE DHE ARGËTIMI NË PORTET DETARE DHE RADA**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenit 32, pika 2, shkronja s) dhe 401, pika b, i ligjit Nr. 9251 datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me qëllim rregullimin e aktivitetit të mjeteve lundruese të kënaqësisë në portet detare të Republikës së Shqipërisë dhe në radat e tyre përkatëse gjatë sezonit turistik:

URDHËROJ:

1. Ky Urdhër është i zbatueshëm për mjetet lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi, të cilat lejohen që të operojnë në Portet Detare të Republikës së Shqipërisë, rada, si dhe vendet e përgatitura posaçërisht për akostimin e tyre.
2. Agjencia detare lajmëron paraprakisht Kapitenerinë e portit, Portin Detar, si dhe Policinë e Shtetit, për formalitetet e mbërritjes së mjetit lundrues, që kërkon të operojë në portin detar për qëllime turizmi dhe argëtimi.
3. Lajmërimi duhet të përcaktojë arsyet e operimit në port, shërbimin që do të kryejë, koha e qëndrimit, personat në bord, si dhe çdo informacion tjetër i kërkuar nga Kapiteneria e Portit apo Porti Detar.
4. Në rastet kur mjeti lundrues kërkon të qëndrojë përkohësisht për furnizime bordi, Kapiteneria e Portit përkatës lejon akostimin e mjetit lundrues vetëm pasi agjencia detare që përfaqëson mjetin turistik të ketë paraqitur pranë kapitanerisë miratimin e autoritetit portual për kalatën ku do të akostohet mjeti.

5. Pavarësisht miratimit nga autoriteti portual dhe kapitaneria e portit, mjete lundrues nuk do të bëhet pengesë për përpunimin e mjeteve të tjera lundruese. Në çdo rast këto mjete duhet të jenë në gatishmëri të lirojnë menjëherë kalatat pas njoftimit nga kapitenaria.
6. Mjetet turistike, do të lejohen të qëndrojnë në radat e portit pa kufizim, duke zbatuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga Kapitenaria e Portit përkatës.
7. Personat që do të vizitojnë vendin tonë me mjete për qëllime turistike dhe argëtimi zbatojnë gjithë legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
8. Detyrimin për përmbushjen e kushteve të sipërme e kanë si subjektet që zotërojnë mjetet lundruese dhe agjencitë detare që i përfaqësojnë ato.
9. Mos plotësimi i detyrimeve do të ndëshkohet me masa administrative në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi.
10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare dhe Portet Detare për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Belinda Balluku

